



RAPORTI I PËRPUTHSHMËRISË SË MONITORIMIT TË PERFORMANCËS NË NIVEL BASHKIE

TËTOR 2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Publikuar nga:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Drejtoria e Financave Vendore
Tiranë, Tetor 2022

**Kontribues në Raportin e Përputhshmërisë
të Monitorimit të Performancës në Nivel Bashkie:**

Prof. As. Dr. Fran Brahimi,
MSc. Elidona Durmishi,
MSc. Almira Ferraj

Ministria e Financave dhe Ekonomisë falenderon për kontributin e tyre:
Ministrinë e Punëve të Brendshme, Projektin “Bashki të Forta”,
Projektin “Financat Lokale”, INSTAT/SALSTAT

Ky raport mundësohet nga:
“Bashki të Forta”

Copyright ©

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ky raport nuk mund të riprodhohet, shpërndahet apo transmetohet në asnjë format,
duke përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo metoda të tjera elektronike,
pa lejen e shkruar të autorit, përveç rasteve të referencave në botime të tjera dhe
përdorimit jo-komercial sikurse parashikuar në ligjin për të drejtat e autorit.

Ky projekt është inicuar dhe financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC,
dhe zbatohet nga Helvetas.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



HELVETAS
ALBANIA



BASHKI të FORTA

**RAPORTI
I PËRPUTHSHMËRISË
SË MONITORIMIT
TË PERFORMANCËS
NË NIVEL BASHKIE
TETOR 2022**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Lista e Shkurtimeve

GMS	Grupi për Menaxhimin Strategjik
IPF	Instrument i Planifikimit Financiar
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PB	Programet e Buxhetit
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PFA	Planifikimi Financiar Afatmesëm
RM	Raport Monitorimi
RMZB	Raportet e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit
TP	Tregues Performance

Tabela e Përmbajtjes

PARATHËNIE	7
1. HYRJE	9
2. METODOLOGJIA	11
3. PËRPUTHSHMËRIA ME KRITERET E RAPORTIMIT	16
3.1. REZULTATET SIPAS BASHKISË	16
4. REKOMANDIME	47

Lista e Tabelave

Tabela 1: Lista e 20 programeve të miratuara nga MFE-ja për pushtetin vendor	12
Tabela 2: Shembuj të qëllimeve dhe të objektivave të një programi	12
Tabela 3: Kriteret e vlerësimit dhe përmasa e kampionit	14
Tabela 4: Statusi i plotësimit të kriterit	15
Tabela 5: Pikëzimi i përputhshmërisë	15
Tabela 6: Përdorimi i treguesve të performancës	29
Tabela 7: Grupi i bashkive me përputhshmëri më të lartë me kërkesat e udhëzimit	46

Lista e Hartave

Harta 1: Bashkitë që kanë dorëzuar një Raport Monitorimi në vitin 2021	17
Harta 2: Klasifikimi i shpenzimeve sipas programeve në vitin 2021	19
Harta 3: Klasifikimi i shpenzimeve sipas aktivitetit ekonomik në vitin 2021	21
Harta 4: Raportimi për investimet kryesore të vitit 2021	23
Harta 5: Përdorimi i treguesve të performancës në dokumentet e RMZB-së në vitin 2021	27
Harta 6: Raportimi i treguesve financiarë të vitit 2021	31
Harta 7: Raportimi i të ardhurave sipas burimit në vitin 2021	33
Harta 8: Raportimi i të ardhurave të planifikuara kundrejt atyre të realizuara në vitin 2021	35
Harta 9: Ecuria e detyrimeve të prapambetura të raportuara në vitin 2021	37
Harta 10: Diferenca midis buxhetit të planifikuar dhe atij të raportuar në vitin 2021	39
Harta 11: Vendosja e RMZB-së 2021 në web	41
Harta 12: Përdorimi i raportit në Këshillat Bashkiake 2021	43
Harta 13: Renditja e përputhshmërisë së RMZB-së në vitin 2021 me kuadrin ligjor	45

Parathënie

Pushteti vendor luan një rol mjaft të rëndësishëm si në cilësinë e shërbimeve që janë shumë afër jetës së qytetarëve ashtu edhe si një instrument i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të shoqërisë në tërësi. Fokusi në procesin e reformimit të funksionimit të pushtetit vendor por gjithashtu edhe rritjes së kapacitetit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet mekanizmave të decentralizimit kanë rritur pritshmëritë e shoqërisë ndaj shërbimeve që ofrojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka vendosur në objektivat e saj strategjike decentralizimin fiskal dhe modernizimin e menaxhimit të financave publike në nivel vendor.

Rritja e kërkesës së qytetarëve për shërbime cilësore dhe sa më pranë tyre ka diktuar domosdoshmërinë e një decentralizimi të thelluar fiskal dhe transferimin e shumë funksioneve publike drejt njësive të vetëqeverisjes vendore. Krijimi i hapësirës së nevojshme fiskale dhe kapaciteteve njerëzore për zbatimin e funksioneve ligjore është një ndër synimet bazë të forcimit të rolit të pushtetit vendor. Në këtë kontekst, rritja e kompleksitetit të funksioneve e përgjegjësisë ndaj qytetarëve do të pasqyrohet në përmirësimin e hapave të menaxhimit të financave publike në nivel vendor si një instrument shumë i rëndësishëm i këtij procesi.

Unifikimi i proceseve të menaxhimit të financave publike në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, unifikimi i metodologjive me ato të zbatuara në nivel qendror dhe përbushja e të gjitha kërkesave ligjore, janë disa nga objektivat kryesore të realizuara përgjatë viteve të fundit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në drejtim të konsolidimit financiar në nivel vendor.

Përballimi i një sfide të madhe ekonomike dhe buxhetore nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për shkak të pasojave të shkaktuara

nga tërmeti dhe pandemia COVID-19 janë një tregues pozitiv i punës së zhvilluar në këto vite në drejtim të stabilitetit makroekonomik, parashikueshmërisë së fondeve dhe transparencës së përdorimit me disiplinë të fondeve buxhetore.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, gjatë vitit 2021 kanë filluar të konsolidojnë ecurinë e përdorimit të standardit të unifikimit të shpenzimeve vendore jo vetëm në nivel llogarie ekonomike por gjithashtu edhe programi e funksioni. Përfundimi i këtij procesi do të përmbyllë një etapë të rëndësishme në rrugën drejt unifikimit në AFMIS në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Pushteti Vendor pas reformës administrativo-territoriale dhe miratimit të ligjit bazë për financat e vetëqeverisjes vendore, hyri në një fazë të rëndësishme të konsolidimit fiskal të menaxhimit financiar publik.

Menaxhimi i financave publike vendore ka qenë dhe mbetet një çështje e rëndësishme në punën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Disa prej arritjeve më të rëndësishme në proceset e menaxhimit të financave vendore gjatë vitit 2021, paraqiten si më poshtë:

- Përmirësimi i menaxhimit të financave vendore përmes rritjes së peshës së taksave vendore në të ardhurat vendore.
- Rritja e mbështetjes së dhënë nga buxheti qendror për pushtetin vendor në formën e transfertave (transferata e pakushtëzuar dhe sektoriale).
- Ruajtja e qëndrueshmërisë së transfertës së pakushtëzuar pavarësisht problemeve të shkaktuara si pasojë e pandemisë COVID-19.
- Shpërndarja e Tatimit mbi të Ardhurat Personale. Shpërndarja e plotë e këtij burimi u dha mundësi financiare shtesë njësive të vetëqeverisjes vendore për të amortizuar

- vështirësitë dhe rritur efektshmërinë e shërbimeve.
- Reforma e iniciuar nga Qeveria (Ministria e Financave dhe Ekonomisë) në taksën e pasurisë është pasqyruar në rritjen e të ardhurave të pushtetit vendor nga kjo taksë.
 - Konsolidimi i procedurave dhe sistemi i menaxhimit të financave vendore në të gjithë etapat, që nga hartimi i programit buxhetor afatmesëm tek zbatimi dhe monitorimi i tij; harmonizimi dhe unifikimi i procedurave për hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
 - Zbatimi i metodologjisë për hartimin e programit buxhetor afatmesëm në nivel produkti buxhetor, përmes formateve të reja të miratuara në udhëzimin vjetor;
 - Prezantimi dhe përdorimi i treguesve të performancës në PBA dhe ndikimi pozitiv në rritjen e cilësisë së monitorimit të zbatimit të buxhetit vendor;
 - Monitorimi i vazhdueshëm i treguesve fiskalë të zbatimit të buxhetit 2021, në funksion të zbatimit të atyre politikave buxhetore që do të rrisin efikasitetin dhe efektshmërinë e përdorimit të fondeve publike në nivel vendor;
 - Përgatitja dhe publikimi periodik dhe vjetor i raportit të analizës së financave publike vendore për vitin 2021;
 - Hartimi i raporteve periodike të menaxhimit të vështirësive financiare, si një detyrim ligjor për të monitoruar situatën financiare të njëjësive të vetëqeverisjes vendore; publikimi i raportit vjetor: "Mbi statusin e vështirësive financiare të njëjësive të vetëqeverisjes vendore", për vitin 2021;
 - Asistenca e drejtpërdrejtë ndaj NJVQV-ve, në të gjitha hapat e menaxhimit financiar në nivel vendor përmes komenteve dhe konsultimit jo vetëm të hartimit të programit buxhetor afatmesëm por edhe të raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit 2021;
 - Realizimi i trajnimeve, takimeve dhe konsultimeve të vazhdueshme me NJVQV-të në kuadër të masave të marra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për menaxhimin financiar në nivel vendor, si një hap parapërgatitor për zbatimin e sistemit AFMIS në nivel vendor në një periudhë afatmesme.

Zbatimi i kujdesshëm i të gjitha këtyre masave nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë vitit 2021, janë një tregues i rëndësishëm për rritjen e autonomisë financiare të njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe për rrjedhojë rritjen e cilësisë së shërbimeve të rëndësishme për jetën e qytetarëve. Përballimi i një sfide të madhe ekonomike dhe buxhetore nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2021, është një tregues pozitiv i punës së zhvilluar në këto vite në drejtim të stabilitetit makroekonomik, parashikueshmërisë së fondeve dhe transparencës së përdorimit me disiplinë të fondeve buxhetore.

Në funksion të reformimit dhe modernizimit të financave publike dhe kryesisht atyre vendore, në strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike është parashikuar që në vitet e ardhshme në sistemin IPSIS të përfshihen dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Po ashtu strategjia e MFP-së parashikon që edhe AFMIS-i të jetë i zgjeruar dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Këto sisteme (IPSIS dhe AFMIS) që parashikohet të jenë funksionale në vitet e ardhshme do të jenë një vlerë e shtuar e Menaxhimit Financiar Publik në nivel vendor. Ato do të unifikojnë të gjithë punën dhe operacionet financiare në të gjitha fazat dhe ciklet e menaxhimit financiar, do të mundësojnë një komunikim të efektshëm midis institucioneve dhe njëjësive qendrore me ato vendore dhe sigurisht do të jenë një garanci më shumë për përdorimin e fondeve publike më efikasitet, ekonomi dhe efektshmëri.

Në hartimin e këtij raporti kanë kontribuar shumë aktorë që punojnë prej vitesh në modernizimin e qeverisjes vendore në vendin tonë. Falënderojmë projektin "Bashki të Forta" për mbështetjen e vazhdueshme të qeverisjes vendore dhe konkretisht për hartimin e këtij raporti. Po ashtu falënderojmë projektin "Financat Lokale", për mbështetjen e njëjësive të vetëqeverisjes vendore. Falënderojmë Ministrinë e Brendshme, Shoqatën për Autonominë Vendore, stafet e njëjësive të vetëqeverisjes vendore, donatorë të tjerë që operojnë në qeverisjen vendore dhe aktorë të tjerë që kanë kontribuar dhe kontribuojnë për qeverisjen vendore në vendin tonë.

1. Hyrje

Raporti i përputhshmërisë së monitorimit të performancës në nivel bashkie, ka si qëllim kryesor përmirësimin e procesit të monitorimit të zbatimit të buxhetit në nivel vendor, nëpërmjet verifikimit dhe renditjes së bashkive sipas nivelit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve për përdorimin me efikasitet, efektshmëri dhe transparencë të fondeve publike vendore. Ky raport nxirret për të katërtin vit radhazi dhe do të vijojë të përgatitet dhe publikohet dhe në vitet në vijim. Nga viti në vit raporti është përmirësuar nga pikëpamja metodologjike duke synuar që kriteret dhe treguesit të jenë të matshëm dhe njëkohësisht të jenë përfaqësues të problematikave të buxhetimit dhe menaxhimit financiar vendor.

Si pjesë e këtij raporti, në ndryshim nga vitet e mëparshme do të paraqitet një krahasimi i periudhës 4-veçare për çdo kriter të plotësuar nga bashkitë, duke analizuar dhe pasqyruar faktin nëse procesi i monitorimit ka ardhur duke u përmirësuar apo përkeqësuar. Kjo analizë ndihmon bashkitë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për përmirësimin e proceseve të cilat nuk kanë pasur ecuri pozitive në plotësimin dhe përgatitjen e raporteve të monitorimit.

Ky raport dhe raporte të tjera vjetore që lidhen me menaxhimin financiar, do të jenë instrumente vlerësimi për skemat dhe bonuset e ndryshme financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, ky raport do të jetë një instrument i vlerësimit të nevojave dhe kryerjes së trajnimeve për çështje të ndryshme të menaxhimit financiar vendor edhe për njësi të veçanta të vetëqeverisjes vendore.

Monitorimi i zbatimit të buxhetit, si pjesë përbërëse e procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor është në fokusin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për t'u zbatuar në të gjitha NJVQV-të. Këto procese janë tashmë të unifikuara nga kuadri ligjor dhe

nëligjor për financat e vetëqeverisjes vendore dhe po zbatohen me asistencën e projektit "Bashki të Forta" dhe "Financat Lokale".

Qëllimi i Strategjisë së Financave Publike në nivel vendor është garantimi i një sistemi të financave publike që nxit transparencën, llogaridhënien, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e kontributeve të taksapaguesve për ofrimin e shërbimeve publike dhe zhvillimin ekonomik. Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike në nivel vendor për periudhën afatmesme do të fokusohet në disa drejtime kryesore:

- Fuqizimi i zbatimit të ligjit për financat e vetëqeverisjes vendore dhe praktikave më të mira të menaxhimit të financave publike në nivel vendor. Forcimi i planifikimit strategjik dhe menaxhimit të buxhetit në nivel vendor;
- Përmirësimi i efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave për të pasur më shumë qëndrueshmëri në financimin e buxhetit në nivelet e qeverisë qendrore dhe vendore;
- Një disiplinë më të fortë financiare, kontrolli dhe transparencë nëpërmjet përmirësimit të auditimit të brendshëm dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK-së) në nivelet e qeverisë qendrore dhe vendore;

- Rritja e kapaciteteve të stafit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të menaxhuar reformat e menaxhimit të financave publike në nivelin e qeverisjes vendore;
- Përgatitja, testimi dhe vënia në funksionim e AFMIS-it në nivel vendor;
- Zbatimi i IPSIS-it në nivel vendor.

Rritja e autonomisë fiskale dhe financiare e vetëqeverisjes vendore duhet të shoqërohet me një rritje të cilësisë së shërbimeve që ofrojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke siguruar një përdorim efikas, të efektshëm dhe ekonomik të burimeve financiare në dispozicion. Për të harmonizuar rritjen e autonomisë me disiplinën fiskale e financiare, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar një paketë aktesh nën-ligjore që forcojnë dhe harmonizojnë proceset e hartimit, zbatimit, raportimit, monitorimit e transparencës së buxheteve vendore, të cilat janë fokusuar në:

- Forcimin e disiplinës fiskale dhe financiare nëpërmjet ushtrimit të detyrueshëm të PBA-së në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- Unifikimin e procedurave të hartimit të projektbuxhetit afatmesëm në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- Përmirësimin e procesit dhe përgatitjes së raporteve të monitorimit përmes rritjes së kapaciteteve të njësive të vetëqeverisjes vendore;
- Buxhetimin mbi bazën e programeve të standardizuara duke rregulluar në këtë

mënyrë organizimin e shpenzimeve sipas funksioneve;

- Verifikimin e bashkive për problemet financiare, duke i klasifikuar në bashki:
 - a) me probleme financiare;
 - b) në vështirësi;
 - c) në vështirësi serioze financiare dhe;
 - d) në pamundësi financiare (falimentuar).

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nëpërmjet Drejtorisë së Financave Vendore i ka orientuar prioritetet e planit të punës në drejtim të:

- Përmirësimin të raporteve të monitorimit, duke u fokusuar te: parandalimi i krijimit të detyrimeve të prapambetura, raportimi në bazë performace, raportimi i shpenzimeve operative, të personelit dhe investimeve në drejtim të efektshmërisë së tyre në rritjen e cilësisë së shërbimeve publike etj;
- Përmirësimin të aftësive monitoruese dhe raportuese për të identifikuar në kohë probleme potenciale gjatë zbatimit të buxhetit nëpërmjet organizimit të trajnimeve periodike të stafit të drejtorive të financës dhe buxhetit;
- Përmirësimin të raportimit dhe monitorimit të performancës për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet rritjes së cilësisë në mënyrën dhe përmbajtjen e raportimit të zbatimit të buxhetit vendor;
- Menaxhimit të efektshëm të të ardhurave, duke rishikuar politikën e taksave me qëllim rritjen e efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave vendore, zvogëlimin të hendekut tatimor dhe luftimit të evazionit fiskal dhe ekonomisë informale;
- Ndjekjes dhe rekomandimeve lidhur me parashikimin shumë optimist të të ardhurave vendore, dukuri e cila në vitet e kaluara është shoqëruar me buxhete të paqëndrueshme duke krijuar rreziqe për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

2. Metodologjia

Shpjegimi i termave kryesore



Struktura e Programit: Buxhetimi i bazuar në programe ka evoluar në dekadat e fundit, i mbështetur gjithashtu edhe nga politikat dhe rekomandimet e Bankës Botërore në zbatim të ristrukturimit dhe përmirësimit të proceseve ekzistuese të buxhetit. Metodologjia e miratuar për hartimin e programit buxhetor afatmesëm ka përfshirë pjesë të saj deklarativën e misionit, përcaktimin e qëllimeve dhe objektivave kjo për të shpjeguar pse po shpenzohen paratë publike. Kjo formë buxhetimi është një mënyrë për të alokuar burimet dhe për të arritur objektiva specifike bazuar në qëllimet e programit dhe rezultatet e matura.”¹

Në këtë qasje i gjithë kuadri i planifikimit dhe i buxhetimit është i orientuar drejt rezultateve.



Treguesit e performancës: Njësitë e matjes që ndihmojnë për vlerësimin e arritjes së objektivave që ka vendosur një bashki për secilin ose për të gjitha programet e buxhetit për një periudhë kohore prej një viti. Treguesit e performancës në lidhje me programet buxhetore janë zakonisht jofinanciarë.



Monitorimi i zbatimit të buxhetit: Monitorimi është një proces i vetëvlerësimit të performancës, i cili arrihet nëpërmjet krahasimit të treguesve të planifikuar me performancën faktike, siç përcaktohet në Udhëzimin e MFE-së nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”.



Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit: Është instrumenti kryesor raportues i përdorur nga bashkitë për të raportuar mbi zbatimin e buxhetit. Raporti jep një përmbledhje të hollësishme të shpenzimeve sipas programit, klasifikimit ekonomik, duke krahasuar shifrat e planifikuara kundrejt faktit duke nxjerrë në këtë mënyrë shkallën e zbatimit.



Raportet e performancës: Janë versionet e përmbledhura për përdoruesit e Raporteve të Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit që 43 bashki arritën të përgatitin për vitin 2021. Këto formate kanë prirje të ndërthurin kërkesat ligjore për të dhëna financiare dhe jofinanciare në një format të shkurtër, konciz dhe të saktë që është i projektuar kryesisht për qëllime informimi dhe komunikimi me organin legjislativ, me qytetarët dhe me strukturat e tjera qeveritare.

1) K. Carter, Rishikimi i buxhetimit të bazuar në performancë: Raport për Reformën e Buxhetit të Shtetit – Financat legjislative, Dokumenti 91, Denver, Konferenca Kombëtare e Legjislativave Shtetërore, fq. 2-3

Tabela 1: Lista e 20 programeve të miratuara nga MFE-ja për pushtetin vendor (lista e programeve është ndryshuar me udhëzimin nr. 7 datë 25.02.2022, "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore").

Emri i programit
P.01110 Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi
P.03140 Shërbimet e policisë vendore
P.03280 Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile
P.04130 Mbështetje për zhvillimin ekonomik
P.04220 Shërbimet bujqësore, inspektimi dhe siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit
P.04240 Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit
P.04260 Administrimi i pyjeve dhe kullotave
P.04520 Rrjeti rrugor rural
P.4570 Transporti publik
P.05100 Menaxhimi i mbetjeve
P.06140 Planifikimi urban vendor
P.06210 Programet e zhvillimit
P.06370 Furnizimi me ujë dhe kanalizimet
P.07220 Shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor
P.08130 Sport dhe argëtim
P.08220 Trashëgimia kulturore, ngjarjet artistike dhe kulturore
P.09120 Arsimi bazë përfshirë parashkollorin
P.09230 Arsimi i mesëm i përgjithshëm
P.10430 Përkujdesi Social
P.10661 Strehimi social

Tabela 2: Shembuj të qëllimeve dhe të objektivave të një programi

P.05100 Menaxhimi i mbetjeve	
Qëllimi i programit	Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane;
Objektivi i programit	Rritja e mbulimit me shërbim; % e mbetjeve që i nënshtrohet proceseve ricikluese; Rritja e frekuencës së mbledhjes së mbetjeve
Treguesit e performancës	Të ardhurat nga tarifat e shërbimit për 1 ton mbetje të menaxhuara, pjesa e komunitetit e mbuluar me shërbim (zonat rurale + urbane)

Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22, datë 30.08.2018, „Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të NJVQV-ve“ është nxjerrë në zbatim të Ligjit 68/2017 „Për financat e vetëqeverisjes vendore“ në lidhje me ciklin e monitorimit dhe raportimit të NJVV-ve. Sipas tij, bashkitë duhet të hartojnë 3 raporte monitorimi gjatë një viti, ku raporti i fundit të mbulojë tërë vitin.



Struktura dhe Përmbajtja e Raportit të Monitorimit është një nga pjesët kryesore që trajtohet nga udhëzimi, duke përbërë themelin e metodologjisë së Raportit. Më poshtë shpjegohen kërkesat ligjore në lidhje me këtë pjesë:

- ✓ *Parathënia: Përshkrim i përgjithshëm i procesit të monitorimit dhe zbatimit të buxhetit;*
- ✓ *Detaje mbi politikat dhe objektivat e programeve specifike të shoqëruara me mënyrën e arritjes së tyre përmes mbledhjes së të ardhurave dhe alokimit të shpenzimeve;*
- ✓ *Plotësimi i anekseve të paracaktuara ku të gjitha vlerat janë renditur sipas vlerave të planit dhe vlerave faktike të periudhës nën vëzhgim.*

i) Aneksi 1: Raporti i shpenzimeve sipas programeve.

ii) Aneksi 2: Raporti i shpenzimeve të programeve sipas zërave.

iii) Aneksi 3: Raporti i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit.

iv) Aneksi 4: Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit.

v) Aneksi 5: Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe të huaj.

- ✓ *Pjesa përshkuese me shpjegime për secilin prej formateve të mësipërme.*

i) Rezultatet sipas programit dhe masat e marra për përmirësimin e rasteve problematike për shkak të ndryshimeve krahasuar me planin fillestar.

ii) Niveli i zbatimit të treguesve të performancës në krahasim me planin.

iii) Niveli i zbatimit të produkteve në krahasim me planin në sasi dhe vlerë duke zbuluar kështu kostot për njësi.

iv) Niveli i arritjeve të qëllimeve dhe objektivave të programeve që mbulojnë çështjet gjinore.

v) Shpjegimet në rastet e ndryshimeve të shpenzimeve buxhetore krahasuar

me planin fillestar në nivel të një programi ose në një veprimtari ekonomike të pasqyruar në nivel produkti dhe në nivel të treguesve të performancës.

vi) Analiza e nivelit të zbatimit të investimeve në nivel vendor.

vii) Afati dhe struktura e detyrimeve tatimore të identifikuar, të cilat nuk mblidhen në afat.

viii) Treguesit kryesorë financiarë.

Kërkesa të tjera thelbësore që nënkuptohen:

- Raporti i Monitorimit përfshin informacion financiar dhe jofinanciar (produkte të tilla si km rrugë dhe tregues të performancës të shprehur në përqindje).
- Të ardhurat sipas burimeve dhe realizimi i tyre është një informacion i rëndësishëm pjesë e raporteve të monitorimit të paraqitura nga bashkitë në vitin 2021.
- Formatet e raportimit dhe përshkrimet e informacionit financiar dhe jofinanciar të përfshira në raportet e monitorimit duhet të plotësojnë kërkesat e udhëzimit, ndërkohë që duhet të jenë edhe miqësore me përdoruesit, me një gjuhë lehtësisht të lexueshme dhe gjithëpërfshirëse, në mënyrë që t'i komunikojnë gjetjet tek aktorët e ndryshëm.
- E fundit, por jo më pak e rëndësishme, cilësia dhe besueshmëria e të dhënave të siguruarra financiare apo teknike ka një rëndësi të madhe përtej përputhshmërisë me kërkesën ligjore për të përmbushur misionin e monitorimit dhe raportimit të zbatimit të buxhetit të NJVQV-ve.

Raportet e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit, të miratuara nga këshilli bashkiak, dorëzohen në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, sipas Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018. Këto dokumente kontrollohen nga Drejtoria e Financave Vendore në MFE, ku vërejtjet dhe rekomandimet i dërgohen secilës njësi të vetëqeverisjes vendore. Analiza e RMZB-së së paraqitur është bërë në mënyrë më të zgjeruar për qëllimin e Raportit Kombëtar. Puna përgatitore vijoi në tri faza:

a) Puna në zyrë:

Gjatë së cilës u analizuan dhe u krahasuan me kujdes raportet vjetore të paraqitura të monitorimit në raport me listën e kërkesave ligjore të renditura në Tabelën 3, e cila tregon të gjitha kriteret e marra në shqyrtim për qëllimin e këtij raporti dhe përmasës së kampionit - numri i bashkive për të cilat është kryer vëzhgimi.

Tabela 3: Kriteret e vlerësimit dhe përmasa e kampionit

	Kriteret e vlerësimit	Përmasa e kampionit bashkiak
Kërkesat e përputhshmërisë	Përgatitja e një raporti	61
	Paraqitja e të ardhurave sipas burimeve	61
	Realizimi faktik i të ardhurave	61
	Shpenzimet sipas programit dhe realizimit	61
	Raportimi i shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik	61
	Lista e investimeve	61
	Shkalla e detyrimeve të prapambetura	61
	Buxheti i planifikuar kundrejt buxhetit faktik	61
	Përputhshmëria e programeve të raportuara në PBA dhe RMZB	61
	Lista e Treguesve Financiarë	61
	Elementet e performancës	61
	Lidhja e elementeve të performancës të planifikimit me raportimin	Metodë Cilësore
	Përdorimi i raportit nga këshilli bashkiak dhe komuniteti	Raporti është diskutuar në këshill
Raporti është publikuar në faqen në internet		61
Renditja e Bashkive	Pikëzim për bashki në bazë të kriterëve të plotësuar (kampioni 61 bashki)	

Kur vëzhgimi nuk është kryer në 61 bashki, dhe përmasa e kampionit është rrjedhimisht më e vogël se 61, atëherë përdoret metoda e vlerësimit cilësor e cila fokusohet në vëzhgimin e dokumentacionit në mënyrë të përzgjedhur me një bashki përfaqësuese për qark.

Të dhënat janë kodifikuar si vijon: elementi që është i pranishëm korrespondon me "po", elementi që nuk është i pranishëm korrespondon me "jo", elementi pjesërisht i pranishëm korrespondon me "pjesërisht".

b) Vizitat në terren:

Vizitat në terren janë realizuar pothuajse në të gjitha bashkitë për të kuptuar sfidat dhe përparimin e bashkive, veçanërisht në lidhje me përdorimin e elementeve të performancës, cilësinë e të dhënave teknike dhe financiare të raportuara, proceset e brendshme dhe aktorët kryesorë të përfshirë në përgatitjen e raportit të monitorimit.

c) Krijimi i bazës së të dhënave dhe analiza e të dhënave:

Përmasa e kampionit: Vlerësimi i RMZB-së është bërë në 61 bashki; kështu, kampioni përfshin të gjitha bashkitë për shumicën e zërave subjekt të vëzhgimit.

Siç tregon tabela, kriteret klasifikohen në:

- Kriteret e kërkesave të përputhshmërisë;
- Përdorimi nga këshilli dhe komuniteti.

Rezultatet analizohen në tekst. Raporti ofron edhe një analizë më të thelluar të përdorimit të elementeve të performancës në kreun përkatës.

Ecuria e bashkive në krahasim me një vit më parë

Për çdo kriter është krahasuar statusi i plotësimit me një vit më parë. Kriteri është cilësuar me «përmirësim», «njësoj», «përkeqësim» ku:

Tabela 4: Statusi i plotësimit të kriterit

Statusi	Shpjegimi i Statusit
Përmirësim	• Nëse kriteri nuk është plotësuar në vitin 2020 dhe në 2021 është plotësuar, si dhe nëse në vitin 2020 është plotësuar pjesërisht dhe në vitin 2021 është plotësuar krejtësisht.
Njësoj +	• Nëse kriteri është plotësuar si në vitin 2020 ashtu edhe në vitin 2021.
Njësoj -	• Nëse kriteri nuk është plotësuar si në vitin 2020 ashtu edhe në vitin 2021.
Përkeqësim	1. Nëse kriteri është plotësuar në vitin 2020 dhe nuk është plotësuar në vitin 2021. 2. Nëse kriteri është plotësuar në vitin 2020 dhe është plotësuar pjesërisht në vitin 2021. 3. Nëse kriteri është plotësuar pjesërisht në vitin 2020 dhe nuk është plotësuar në vitin 2021.

Trendi i ecurisë 4-vjeçare

Duke qenë se është viti i katërt i publikimit të këtij raporti është analizuar ecuria e secilit kriter përgjatë periudhës 2018-2021, e cila rezulton me një vlerësim të kriterit përgjatë periudhës si më poshtë:

Statusi	Shpjegimi i Statusit
Përmirësim	Nëse kriteri është plotësuar nga një numër në rritje njësisish.
Njësoj	Nëse kriteri është plotësuar nga një numër i njëjtë njësisish.
Përkeqësim	Nëse kriteri nuk është plotësuar nga një numër në rritje njësisish.

Renditja e Bashkive

Më pas është zbatuar një pikëzim i përputhshmërisë për të gjitha bashkitë bazuar në kriteret e matura në mënyrë sasiore sipas të cilave ato janë renditur siç tregohet në Tabelën 5.

Tabela 5: Pikëzimi i përputhshmërisë

Pikët	Standardi
10,4 deri në 13 pikë	Përputhshmëri e lartë
7,8 deri në 10,3 pikë	Mbi mesataren
5,2 deri në 7,7 pikë	Mesatare
2,5 deri në 5,1 pikë	Nën mesataren
0 deri 2,4 pikë	Nuk ka përputhshmëri

Kufizimet: Raporti ndërtohet kryesisht mbi kriteret e përputhshmërisë, të cilat përcaktohen në mënyrë sasiore dhe prandaj janë pikëzuar. Një tjetër grup kriteresh po aq të rëndësishme janë ato që vlerësohen vetëm në mënyrë cilësore dhe që nuk pikëzohen.

Qasja pasuese: Raporti Kombëtar ndjek një qasje pasuese që nënkupton se përputhshmëria dhe disponueshmëria e të dhënave janë parakushtet e një produkti më analitik në vitin e ardhshëm.

3 Përputhshmëria me kriteret e raportimit

3.1 Rezultatet sipas bashkive




1. A kanë prodhuar bashkitë raport monitorimi për vitin 2021

Referuar hartës së mëposhtme, për vitin 2021, rreth 55 bashki e kanë prodhuar raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit, ndërsa 6 nuk e kanë prodhuar atë (nuk e kanë paraqitur në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë) dhe konkretisht bashkitë: Pustec, Kavajë, Rogozhinë, Vorë, Konispol, dhe Selenicë.

Referuar grafikut të mëposhtëm ku është marrë në krahasim viti 2021 me vitin 2020 rezultojnë se:

- **Me përmirësim** paraqiten 2 bashki, (Gramsh dhe Tropojë) të cilat nuk e kanë prodhuar raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit në vitin 2020, ndërsa në vitin 2021 e kanë prodhuar atë;
- **Me status të njëjtë pozitiv**, paraqiten 53 bashki të cilat e kanë prodhuar raportin si në vitin 2020 ashtu edhe në vitin 2021.
- **Me status të njëjtë negativ**, paraqiten 6 bashki (Pustec, Kavajë, Rogozhinë, Vorë, Konispol, dhe Selenicë), bashki këto të cilat nuk e kanë prodhuar raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit si në vitin 2020 ashtu edhe në vitin 2021.

Harta 1: Bashkitë që kanë dorëzuar një Raport Monitorimi në vitin 2021




Referuar grafikut më poshtë, për trendin 4-vjeçar të treguesit nëse bashkitë kanë prodhuar raport vjetor të monitorimit të zbatimit të buxhetit, rezulton se ky trend ka ardhur duke u përmirësuar nga viti në vit.

Për vitin 2018, nga 61 bashki, 51 e kanë prodhuar raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Për vitin 2019 krahasuar me 2018, ky tregues paraqitet i përmirësuar me trend

në rritje me 2 bashki më shumë, pra numri ka shkuar në 53 bashki të cilat e kanë prodhuar këtë raport. Për vitin 2020, ky trend është në të njëjtën masë me 2019 pra 53 bashki që e kanë prodhuar raportin. Ndërsa për vitin 2021, kemi përmirësim, ku trendi na rezulton me rritje me dy bashki më shumë se viti 2020, duke e çuar numrin në 55 bashki të cilat e kanë prodhuar raportin e monitorimit.




RAPORTI I MONITORIMIT I BUXHETIT PRODHUAR



2. Raportimi i shpenzimeve sipas programeve dhe kërkesave të Aneksit 1

Referuar hartës së mëposhtme, rezulton se bashkitë të cilat e kanë prodhuar raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2021 55 bashki, kanë bërë edhe raportimin sipas programeve buxhetore duke përmbushur kështu kërkesat e Aneksit 1. Raportimi në nivel programi nuk është bërë vetëm nga 6 bashkitë të cilat nuk e kanë prodhuar raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2021.

Harta 2: Klasifikimi i shpenzimeve sipas programeve në vitit 2021




Referuar grafikut të mëposhtëm ku është krahasuar viti 2021 me vitin 2020 për raportimin e shpenzimeve sipas programeve, rezulton se:

- **Me përmirësim** paraqiten 3 bashki (Dibër, Gramsh dhe Tropojë) të cilat në vitin 2020 nuk kanë raportuar shpenzimet sipas programeve duke mos përmbushur kërkesat e Aneksit 1, ndërsa në vitin 2021 kanë raportuar sipas këtyre kërkesave;
- **Me status të njëjtë pozitiv** paraqiten 52 bashki të cilat kanë raportuar sipas kërkesave të Aneksit 1 si në vitin 2020 ashtu edhe në vitin 2021;

Referuar grafikut më poshtë, për trendin 4-vjeçar të treguesit nëse bashkitë kanë raportuar shpenzimet sipas programeve buxhetore sipas kërkesave të Aneksit 1, trendi paraqitet si më poshtë:

Për vitin 2018, nga 61 bashki 43 e kanë bërë raportimin e shpenzimeve sipas programeve buxhetore, për vitin 2019 krahasuar me 2018 ky trend ka ardhur duke u përmirësuar me 10 bashki më shumë duke çuar numrin në 53 bashki të cilat kanë raportuar sipas kërkesave të Aneksit 1, ndërsa për vitin 2020 krahasuar me 2019 kemi përkeqësim pra një trend me ulje me një bashki më pak duke çuar numrin

RAPORTIMI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMIT






- **Me status të njëjtë negativ** paraqiten 6 bashki të cilat nuk kanë raportuar sipas programeve si në vitin 2020 ashtu edhe në vitin 2021 dhe janë po ato bashki të cilat nuk e kanë prodhuar raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2021.

në 52 bashki që raportojnë sipas Aneksit 1, si dhe për vitin 2021 krahasuar me 2020 kemi përmirësim ku trendi ka ardhur me rritje me 3 bashki më shumë duke e çuar numrin në 55.

3. Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik

Referuar hartës së mëposhtme, rezulton se ato bashki të cilat e kanë prodhuar raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2021 55 bashki, e kanë bërë edhe raportimin sipas klasifikimit ekonomik duke përmbushur kështu kërkesat e Aneksit 2. Raportimi në nivel llogarie ekonomike nuk është bërë vetëm nga 6 bashkitë të cilat nuk kanë prodhuar raport monitorimi të zbatimit të buxhetit për vitin 2021.

Harta 3: Klasifikimi i shpenzimeve sipas aktivitetit ekonomik në vitin 2021




Referuar grafikut të mëposhtëm, nëse do të krahasojmë vitin 2021 me vitin 2020 për raportimin sipas klasifikimit ekonomik rezulton se:

- **Me përmirësim** paraqiten 3 bashki (Dibër, Gramsh, dhe Tropojë), të cilat në vitin 2020 nuk kanë raportuar shpenzimet sipas llogarive ekonomike duke mos përmbushur kërkesat e Aneksit 2, ndërsa në vitin 2021 ato kanë raportuar sipas këtyre kërkesave;
- **Me status të njëjtë pozitiv** paraqiten 52 bashki, të cilat kanë raportuar sipas kërkesave të Aneksit 2 si në vitin 2020 ashtu edhe në vitin 2021;
- **Me status të njëjtë negativ** paraqiten 6 bashki, të cilat nuk kanë raportuar sipas llogarive ekonomike si në vitin 2020 ashtu edhe në vitin 2021 dhe janë po ato bashki të cilat nuk e kanë prodhuar raportin e monitorimit për vitin 2021 (Pustec, Kavajë, Rogozhinë, Vorë, Konispol dhe Selenicë).

Referuar grafikut më poshtë, për trendin 4-vjeçar të treguesit nëse bashkitë kanë raportuar shpenzimet sipas llogarive ekonomike sipas kërkesave të Aneksit 2, trendi paraqitet si më poshtë:

Për vitin 2018, nga 61 bashki 39 e kanë bërë raportimin e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike, nga të cilat 32 e kanë për raportimin të plotë dhe 7 prej tyre kanë bërë raportim të pjesshëm. Për vitin 2019 krahasuar me 2018, ky trend ka ardhur duke u përmirësuar duke e çuar numrin në 53 bashki të cilat kanë raportuar sipas kërkesave të Aneksit 2, ndërsa për vitin 2020, krahasuar me 2019, kemi përkeqësim pra trendi është me ulje me një bashki më pak duke çuar numrin në 52 bashki që raportojnë sipas Aneksit 2, ndërsa për vitin 2021 krahasuar me 2020, ky trend paraqitet i përmirësuar me 1 bashki më shumë duke e çuar numrin në 53.




RAPORTIMI SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK



4. Raportimi i projekteve të investimeve me financim të brendshëm dhe të huaj

Referuar hartës së mëposhtme, rezulton se 10 bashki si: Dibër, Memaliaj, Pustec, Kukës, Tropojë, Kavajë, Rogozhinë, Vorë,

Harta 4: Raportimi për investimet kryesore të vitit 2021



Konispol dhe Selenicë nuk kanë raportuar për listën e projekteve të investimeve, ndërsa 4 bashki (Belsh, Gramsh, Patos dhe Vlorë) kanë raportuar pjesërisht dhe 47 bashki kanë raportuar për projektet e investimeve.

Referuar grafikut të mëposhtëm, ku është marrë në krahasim viti 2021 me vitin 2020, për raportimin për listën e investimeve rezulton se:


- **Me përmirësim** paraqiten 4 bashki, përmirësimet këto të cilat konsistojnë në: a) bashki të cilat nuk kanë raportuar në vitin 2020 dhe kanë raportuar në vitin 2021 që janë 3 (Poliçan, Vau i Dejës dhe Kurbin); b) bashki të cilat nuk kanë raportuar për listën e investimeve në vitin 2020 ndërsa në vitin 2021 kanë raportuar pjesërisht, si bashkia Gramsh.
- **Me status të njëjtë pozitiv** paraqiten

44 bashki të cilat kanë raportuar sipas kërkesave të Aneksit 5 si në vitin 2020 ashtu edhe në vitin 2021;

- **Me status të njëjtë negativ** paraqiten 7 bashki të cilat nuk kanë raportuar për listën e investimeve si në vitin 2020 ashtu edhe në vitin 2021 si: Pustec, Tropojë, Kavajë, Rogozhinë, Vorë, Konispol, dhe Selenicë.
- **Me regres** paraqiten 6 bashki, regres i cili konsiston në: a) bashki të cilat kanë raportuar në vitin 2020 dhe nuk kanë raportuar në vitin 2021 që janë 3 (Dibër, Memaliaj dhe Kukës); b) bashki të cilat kanë raportuar për listën e investimeve në vitin 2020 ndërsa në vitin 2021 kanë raportuar pjesërisht të cilat janë 3 (Belsh, Patos dhe Vlorë).

Referuar grafikut më poshtë, për trendin 4-vjeçar të treguesit nëse bashkitë kanë raportuar për projektet e investimeve sipas

RAPORTIMI I PROJEKTEVE TE INVESTIMIT



kërkesave të Aneksit 5, rezulton se edhe ky trend ka ardhur duke u përmirësuar nga viti në vit.

Për vitin 2018, nga 61 bashki 28 e kanë bërë raportimin e projekteve të investimeve sipas kërkesave të Aneksit 5. Për vitin 2019 krahasuar me 2018 ky trend ka ardhur duke u

përmirësuar duke e çuar numrin në 48 bashki nga të cilat 45 kanë raportuar në mënyrë të plotë ndërsa rreth 3 kanë raportuar pjesërisht.

Për vitin 2020, krahasuar me 2019, ky trend është po përmirësuar duke çuar numrin në 50 bashki të cilat kanë raportuar për investimet, si dhe për vitin 2021 krahasuar me 2020, kemi po përmirësuar duke e çuar numrin në 53 bashki, nga të cilat 47 kanë raportuar plotësisht sipas kërkesave dhe 4 kanë raportuar pjesërisht.

5. Programet buxhetore të njëjta në raportin e monitorimit dhe në PBA 2022-2024

Referuar treguesit nëse bashkitë kanë përdorur të njëjtat programe buxhetore gjatë hartimit të PBA-së, si edhe në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit, konstatohet se përgjithësisht bashkitë kanë përdorur të njëjtat programe si në planifikim ashtu edhe në zbatim. Pra janë mbështetur në listën e programeve të përcaktuara sipas shtojcës nr 2, të udhëzimit nr 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar.

Ky tregues është i realizuar nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore përveç 6 bashkive që nuk kanë dorëzuar raportet.

6. Përdorimi i treguesve të performancës (aneksi 3 dhe 4 i raportit të monitorimit)

Referuar hartës së mëposhtme, 37 bashki kanë raportuar sipas kërkesave të aneksit 3 dhe 4, 13 bashki si: Poliçan, Peqin, Divjakë, Pogradec, Pustec, Tropojë, Kavajë, Rogozhinë, Vorë, Konispol, Sarandë, Selenicë dhe Vlorë nuk kanë raportuar sipas kërkesave të aneksit 3 dhe 4, si dhe 11 bashki si: Kuçovë, Belsh, Cërrik, Gramsh, Librazhd, Përrenjas, Këlcyrë, Përmet, Devoll, Has dhe Kamëz kanë raportuar pjesërisht sipas kërkesave të aneksit 3 dhe 4.

Në total 48 bashki kanë raportuar në terma konkrete se për çfarë i kanë shpenzuar paratë me anë të treguesve të performancës.

Referuar grafikut të mëposhtëm, ku është krahasuar viti 2021 me vitin 2020, për raportimin sipas kërkesave të anekseve 3 dhe 4 rezulton se:

- **Me përmirësim** paraqiten 11 bashki, përmirësime këto të cilat konsistojnë në: a) bashki të cilat nuk kanë raportuar në vitin 2020 sipas kërkesave të anekseve 3 dhe 4 dhe kanë raportuar në vitin 2021 që janë 5 (Dimal, Dibër, Durrës, Lushnje dhe Kurbin); b) bashki të cilat nuk kanë raportuar në vitin 2020 ndërsa në vitin 2021 kanë raportuar pjesërisht që janë 6 bashki (Kuçovë, Gramsh, Librazhd, Përrenjas, Devoll dhe Kamëz);


c) bashki të cilat kanë raportuar pjesërisht sipas kërkesave të aneksit 3 dhe 4 në vitin 2020 dhe në vitin 2021 kanë raportuar sipas kërkesave të anekseve 3 dhe 4.

- **Me status të njëjtë pozitiv** paraqiten 35 bashki, të cilat kanë raportuar sipas kërkesave të aneksit 3 dhe 4 si në vitin 2020 ashtu edhe në vitin 2021;
- **Me status të njëjtë negativ** paraqiten 11 bashki, të cilat nuk kanë raportuar sipas kërkesave të anekseve 3 dhe 4 si në vitin 2020 ashtu edhe në vitin 2021 (Poliçan, Peqin, Pogradec, Pustec, Tropojë, Kavajë, Rogozhinë, Vorë, Konispol dhe Selenicë dhe Vlorë);
- **Me regres** paraqiten 4 bashki, regres i cili konsiston në: a) bashki të cilat kanë raportuar në vitin 2020 dhe nuk kanë raportuar në vitin 2021 që është 1, bashkia Sarandë b) bashki të cilat kanë raportuar sipas kërkesave të anekseve 3 dhe 4 në vitin 2020 ndërsa në vitin 2021 kanë raportuar pjesërisht të cilat janë 2 (Këlcyrë dhe Has); c) bashki të cilat kanë raportuar pjesërisht në vitin 2020 dhe në vitin 2021 nuk kanë raportuar që është 1, bashkia Divjakë.



Referuar grafikut më poshtë, për trendin 4-vjeçar të treguesit nëse bashkitë kanë raportuar për treguesit e performancës sipas kërkesave të Aneksit 3 dhe 4, rezulton se edhe ky trend ka ardhur duke u përmirësuar ndjeshëm nga viti në vit.

Për vitin 2018, nga 61 bashki 3 e kanë realizuar raportimin për treguesit e performancës. Për

TREGUESIT E PERFORMANCES ANEKSI 3&4



Harta 5: Përdorimi i treguesve të performancës në dokumentet e RMZB-së në vitin 2021



vitin 2019 krahasuar me 2018, ky trend ka ardhur duke u përmirësuar ndjeshëm duke e çuar numrin në 31 bashki të cilat kanë raportuar sipas kërkesave të Aneksit 3 dhe 4, nga të cilat 25 kanë raportuar plotësisht dhe 6 kanë raportuar pjesërisht. Për vitin 2020 krahasuar me 2019, treguesi është po me përmirësim duke e çuar numrin në 39 bashki që raportojnë për treguesit e performancës nga të cilat 29 kanë raportuar plotësisht dhe 10 bashki kanë raportuar pjesërisht. Gjithashtu, edhe për vitin 2021 trendi paraqitet me përmirësim duke e çuar numrin e bashkive që kanë raportuar për TP-të në 48, nga të cilat 37 kanë raportuar plotësisht dhe 11 pjesërisht.


Treguesit që pasqyrojnë kërkesa për standarde

Në kuadër të bashkëpunimit të Drejtorisë së Financave Vendore me Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë, për të asistuar më tej bashkitë në buxhetimin me bazë performance dhe për të raportuar ofrimin e shërbimit me anë


të treguesve, është shpërndarë një listë me tregues që pasqyrojnë 1) kërkesat ligjore për standarde minimale të ofrimit të shërbimit në nivel vendor 2) prioritete strategjike të përcaktuara në strategji sektoriale dhe ndërsektoriale të ofrimit të shërbimit.

Krahasimi i treguesve të listës me treguesit në raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, anekset 3 dhe 4 si dhe ato të përdorura në raportet e performancës të prodhuara nga bashkitë tregon se bashkitë kanë përdorur rreth 28 tregues në mënyrë më të shpeshtë (nga 15 në 45 bashki) të cilët përkojnë me 21 programe buxhetore/shërbime vendore. Tabela X tregon në mënyrë më cilësore se cilët kanë qenë treguesit e përdorur dhe se sa bashki i kanë përdorur ato.

Vlen të theksohet se, numri i treguesve që pasqyrojnë standard apo prioritet ka pësuar rritje në krahasim me vitin e kaluar. Numri i programeve të mbuluar me tregues është rritur sikurse dhe gama e treguesve të përdorur edhe si pasojë e listës së qarkulluar përpara përpilimit të RMZB-së.



Frekuenca e përdorimit të treguesve të performancës që reflektojnë kërkesa ligjore dhe strategjike (standarte)



7. Përdorimi dhe raportimi i treguesve financiarë

Referuar hartës së mëposhtme, për raportimin e treguesve financiarë sipas bashkive, rezultojnë se 19 bashki nuk kanë raportuar për treguesit financiar si: Poliçan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Këlcyrë, Devoll, Pogradec, Pustec, Has, Tropojë, Mirditë, Kavajë, Rogozhinë, Tiranë, Vorë, Konispol, Sarandë, Selenicë dhe Vlorë, ndërsa 42 bashkitë e tjera kanë raportuar për treguesit financiarë.

Referuar grafikut të mëposhtëm, ku është krahasuar viti 2021 me vitin 2020 për raportimin për treguesit financiar rezultojnë se:


- **Me përmirësim** paraqiten 14 bashki, përmirësime këto të cilat konsistojnë në: a) bashki të cilat nuk kanë raportuar në vitin 2020 treguesit financiarë dhe kanë raportuar në vitin 2021 si: Ura Vajgurore, Bulqizë, Shijak, Elbasan, Përrenjas, Fier, Roskovec,

Dropull, Gjirokastrë, Përmet, Tepelenë, Dibër, Krujë dhe Kamëz.

- **Me status të njëjtë pozitiv** paraqiten 28 bashki, të cilat kanë raportuar për treguesit financiarë si në vitin 2020 ashtu edhe në vitin 2021;
- **Me status të njëjtë negativ** paraqiten 18 bashki, të cilat nuk kanë raportuar si në vitin 2020 ashtu edhe në vitin 2021 si: Poliçan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Devoll, Pogradec, Pustec, Has, Tropojë, Mirditë, Kavajë, Rogozhinë, Tiranë, Vorë, Konispol, Sarandë, Selenicë dhe Vlorë.
- **Me regres** paraqitet 1 bashki, bashkia Këlcyrë e cila ka raportuar në vitin 2020 për treguesit financiarë ndërsa në vitin 2021 nuk ka raportuar.




Referuar grafikut më poshtë, për trendin 4-vjeçar të treguesit nëse bashkitë kanë raportuar për treguesit financiarë rezultojnë si më poshtë:

RAPORTIMI I TREGUESVE FINANCIARE



Për vitin 2018, nga 61 bashki 43 e kanë realizuar raportimin për treguesit financiarë, për vitin 2019 krahasuar me 2018, ky trend ka ardhur duke përqendruar duke e çuar numrin në 39 bashki të cilat kanë raportuar për treguesit financiarë, për vitin 2020 krahasuar me 2019, treguesi është po me përqendrim duke e çuar numrin në 29 bashki që raportojnë për treguesit financiarë, ndërsa për vitin 2021 treguesi paraqitet me trend rritës pra me

Harta 6: Raportimi i treguesve financiarë të vitit 2021



përmirësim duke e çuar numrin e bashkive që kanë raportuar për treguesit financiarë në 42 pra rreth 13 bashki më shumë.

8. Raportimi i të ardhurave sipas burimit

Referuar hartës së mëposhtme, për raportimin e të ardhurave sipas burimit, rezulton se 13 bashki si Poliçan, Belsh, Këlcyrë, Pustec, Has, Tropojë, Mirditë, Kavajë, Rrogozhinë, Vorë, Konispol, Sarandë dhe Selenicë nuk i kanë raportuar të ardhurat sipas burimit, ndërsa pjesa tjetër e bashkive 48 i kanë raportuar ato.

Referuar grafikut të mëposhtëm, ku është marrë në krahasim viti 2021 me vitin 2020 për raportimin e të ardhurave sipas burimit rezulton se:

- **Me përmirësim** paraqiten 6 bashki, përmirësime këto të cilat konsistojnë në: a) bashki të cilat nuk kanë raportuar në vitin 2020 dhe kanë raportuar në vitin 2021 që


janë 5 (Krujë, Gramsh, Peqin, Roskovec, si dhe Pogradec); b) bashki të cilat kanë raportuar pjesërisht në vitin 2020 ndërsa në vitin 2021 kanë raportuar plotësisht për të ardhurat sipas burimit, bashkia Devoll.

- **Me status të njëjtë pozitiv** paraqiten 42 bashki, të cilat kanë raportuar si në vitin 2020 ashtu edhe në vitin 2021;
- **Me status të njëjtë negativ** paraqiten 10 bashki, si: Poliçan, Belsh, Pustec, Has, Tropojë, Kavajë, Rrogozhinë, Vorë, Konispol dhe Selenicë e cilat nuk kanë raportuar si në vitin 2020 ashtu edhe në vitin 2021.
- **Me regres** paraqiten 3 bashki, (Këlcyrë, Mirditë, dhe Sarandë) të cilat kanë raportuar në vitin 2020 për të ardhurat sipas burimit ndërsa në vitin 2021 nuk kanë raportuar.

Referuar grafikut më poshtë, për trendin 4-vjeçar të treguesit nëse bashkitë kanë raportuar për të ardhurat sipas burimit rezulton si më poshtë:

Për vitin 2018, nga 61 bashki pothuajse gjysma e tyre 33 e kanë realizuar raportimin për të ardhurat sipas burimit. Për vitin 2019

TE ARDHURAT SIPAS BURIMIT



krahasuar me 2018, ky trend ka ardhur duke u përkeqësuar duke e çuar numrin në 26. Për vitin 2020 krahasuar me 2019, treguesi është me përmirësim duke e çuar numrin në 46 bashki që raportojnë për të ardhurat sipas burimit. Gjithashtu edhe për vitin 2021 treguesi paraqitet me përmirësim duke e çuar numrin e bashkive që kanë raportuar për të ardhurat sipas burimit në 47.

9. Raportimi i të ardhurave të planifikuara përkundrejt atyre faktike

Referuar hartës së mëposhtme, për raportimin e të ardhurave sipas burimit rezulton se 13 bashki si: Poliçan, Belsh, Këlcyrë, Pustec, Has, Tropojë, Mirditë, Kavajë, Rogozhinë, Vorë, Konispol, Sarandë dhe Selenicë nuk i kanë raportuar të ardhurat sipas planit dhe faktit. Pjesërisht kanë raportuar 2 bashki (Krujë dhe Peqin), ndërsa pjesa tjetër e bashkive 46 bashki kanë raportuar të ardhurat e planifikuara kundrejt të ardhurave faktike.

Referuar grafikut të mëposhtëm, ku është krahasuar viti 2021 me vitin 2020 për raportimin e të ardhurave të planifikuara kundrejt atyre faktike rezulton se:


- **Me përmirësim** paraqiten 9 bashki, përmirësimet këto të cilat konsistojnë në: a) bashki të cilat nuk kanë raportuar në vitin 2020 dhe kanë raportuar në vitin 2021 që

janë 3 (Gramsh, Roskovec dhe Devoll); b) bashki të cilat nuk kanë raportuar në vitin 2020 ndërsa në vitin 2021 kanë raportuar pjesërisht (Krujë dhe Peqin); c) bashki të cilat kanë raportuar pjesërisht në vitin 2020 dhe plotësisht në vitin 2021 (Dropull, Kolonjë dhe Pogradec dhe Kukës).

- **Me status të njëjtë pozitiv** paraqiten 39 bashki, të cilat kanë raportuar si në vitin 2020 ashtu edhe në vitin 2021;
- **Me status të njëjtë negativ** paraqiten 10 bashki, si: Poliçan, Belsh, Pustec, Has, Tropojë, Kavajë, Rogozhinë, Vorë, Konispol dhe Selenicë të cilat nuk kanë raportuar si në vitin 2020 ashtu edhe në vitin 2021.
- **Me regres** paraqiten 3 bashki, Këlcyrë, Mirditë, dhe Sarandë të cilat kanë raportuar në vitin 2020 për të ardhurat e planifikuara kundrejt atyre faktike ndërsa në vitin 2021 nuk kanë raportuar.




Referuar grafikut më poshtë, për trendin 4-vjeçar të treguesit nëse bashkitë kanë raportuar për treguesin të ardhurat e planifikuara kundrejt atyre faktike rezulton se:

TE ARDHURAT PLAN FAKT



Për vitin 2018, nga 61 bashki 32 e kanë realizuar raportimin për të ardhurat e planifikuara kundrejt atyre faktike. Për vitin 2019 krahasuar me 2018, ky trend ka ardhur duke u përkeqësuar duke e çuar numrin në 27 bashki të cilat kanë raportuar për këtë tregues. Për vitin 2020 krahasuar me 2019, treguesi është me përmirësim duke e çuar numrin në 46 bashki që raportojnë për këtë tregues. Gjithashtu edhe për vitin 2021

Harta 8: Raportimi i të ardhurave të planifikuara kundrejt atyre të realizuara në vitin 2021



treguesi paraqitet me trend rritës pra me përmirësim duke e çuar numrin e bashkive që kanë raportuar për të ardhurat e planifikuara kundrejt atyre faktike në 48 pra rreth 2 bashki më shumë.

10. Detyrimet e Prapambetura


Njësitë e vetëqeverisjes vendore në procesin e planifikimit, monitorimit dhe zbatimit të buxhetit duhet të fokusohen në problematikën se detyrimet e prapambetura po shndërrohen në një burim të vazhdueshëm rreziku financiar, si rrjedhojë shlyerja e tyre në kohë do të eliminonte një rrezik potencial fiskal. Stoku i detyrimeve të prapambetura në nivel vendor në fund të muajit dhjetor 2021, ishte rreth **6,6 miliard lekë**. Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është ulur me **0,5 miliard lekë** krahasuar me stokun e detyrimit në fund të vitit 2020, që ishte **7,1 miliard lekë**.

Për vitin 2021, mbështetur në raportin e monitorimit që kanë paraqitur bashkitë si dhe në raportet periodike të prodhuara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), është analizuar shlyerja e detyrimeve të prapambetura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për periudhën 2020-2021. Ky tregues është shumë i rëndësishëm në paraqitjen e


gjendjes financiare të çdo bashkie me qëllim uljen e detyrimit në periudhën afatmesme dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja. Gjithashtu, për vitin 2021, është hartuar edhe raporti i vlerësimit të gjendjes financiare të njësive vendore bazuar në ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Për ato njësi vendore të cilat kanë rritur ndjeshëm detyrimin për vitin 2021 dhe kanë rezultuar në një nga fazat e gjendjes financiare kanë filluar të zbatohen procedurat e përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 26 datë 27.09.2020 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Rezultatet e këtij vlerësimi paraqiten si më poshtë vijon:

Bashkitë janë kategorizuar sipas disa treguesve për uljen ose rritjen e detyrimit nga viti 2020 në vitin 2021. Këta tregues janë shumë të rëndësishëm për të identifikuar ato bashki të cilat kanë pasur një performancë të mirë në procesin e planifikimit, hartimit dhe zbatimit të buxhetit dhe ato të cilat kanë qenë në nivele shumë të ulëta.

Vlerësohen maksimalisht ato bashki të cilat e kanë ulur vlerën e detyrimit në nivelin mbi 30 për qind, duke marrë vlerësimin **1 pikë, 14 bashki** (bashkitë: Bulqizë, Librazhd, Roskovec, Gjirokastrë, Këlcyrë, Tepelenë, Kolonjë, Korçë, Has, Tropojë, Himarë, Sarandë, Selenicë dhe Vlorë).



Harta 9: Ecuria e detyrimeve të prapambetura të raportuara në vitin 2021



Janë vlerësuar me **dy pikë** bashkitë të cilat vlerën e detyrimit e kanë ulur nga 10 % deri në 30 %, **21 bashki** (bashkitë: Kuçovë, Poliçan, Dibër, Klos, Krujë, Shijak, Elbasan, Përrenjas, Divjakë, Lushnje, Libohovë, Memaliaj, Devoll, Pustec, Lezhë, Mirditë, Fushë-Arrëz, Pukë, Rogozhinë, Tiranë, dhe Vorë).

Janë vlerësuar me **3 pikë** ato bashki të cilat vlerën e detyrimit e kanë rritur nga 0-10%, **6 bashki** (bashkitë: Skrapar, Mallakastër, Përmet, Pogradec, Kamëz dhe Delvinë).

Janë vlerësuar me **4 pikë** ato bashki të cilat e kanë rritur vlerën e detyrimit deri në 10%, **4 bashki** (bashkitë: Dimal, Mat, Shkodër dhe Finiq).

Janë vlerësuar me **5 pikë** bashkitë të cilat e kanë rritur vlerën e detyrimit mbi 10 %, **14 bashki** (bashkitë: Berat, Durrës, Belsh, Cërrik, Peqin, Fier, Gramsh, Maliq, Kukës, Kurbin, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Kavajë dhe Konispol), të cilat për shkak të rritjes së nivelit të detyrimit rrezikojnë të gjenden në një prej situatave të vështirësive financiare.

Bashkia Patos, është e vetmja bashki e cila në vitet 2020-2021 nuk ka detyrime të prapambetura. Ndërkohë, bashkia Dropull e cila në vitin 2020, nuk ka pasur detyrime, në vitin 2021, paraqitet me detyrime të krijuara, përgjatë vitit.


11. Buxheti i planifikuar për vitin 2021, kundrejt faktit 2021

Një proces shumë i rëndësishëm për bashkitë është faza e hartimit dhe planifikimit të buxhetit vjetor. Konstatohet se parashikimi shumë optimist i të ardhurave vendore, shoqërohet me buxhete të paqëndrueshme duke krijuar rreziqe për krijimin e detyrimeve të prapambetura. Për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore është analizuar buxheti i planifikuar kundrejt realizimit faktik për vitin 2021. Vihet re se jo të gjitha bashkitë kanë argumentuar në raportin e monitorimit shkaqet dhe arsyet që kanë ndikuar negativisht në realizimin e buxhetit për vitin 2021.

Disa prej shkaqeve kryesore të cilat lidhen drejtpërdrejt me rezultatet e bashkive përsa i përket këtij treguesi janë: mangësitë në parashikueshmërinë e të ardhurave dhe shpenzimeve, procedurat jo të efektshme në procesin e planifikimit të buxhetit, probleme në lidhjen e politikave strategjike me prirotetet e programeve buxhetore, parashikime optimiste të realizimit të të ardhurave, mungesa e lidhjes dhe analizës së priroteteve të bashkisë me burimet e kufizuara në dispozicion, evidentimi jo i saktë i hapësirës fiskale dhe nismave të reja të ndërmarra nga njësia vendore, kapacitete të ulëta për vlerësimin e potencialit fiskal të bashkisë.

Lidhur me këtë tregues bashkitë janë klasifikuar në tri kategori, duke u vlerësuar me performancë shumë të mirë buxhetore, performancë mesatare dhe performancë të dobët.

Harta 10: Diferenca midis buxhetit të planifikuar dhe atij të raportuar në vitin 2021




Janë vlerësuar me **1 pikë** ato bashki të cilat kanë një realizim në nivelet 80%-100% të buxhetit (fakt/kundrejt planit), ose me performancë shumë të mirë buxhetore. Konkretisht rezultojnë **20 bashki** (Kuçovë, Poliçan, Skrapar, Dimal, Bulqizë, Dibër, Belsh, Cërrik, Këlcyrë, Memaliaj, Tepelenë, Kolonjë, Has, Kukës, Tropojë, Mirditë, Pukë, Delvinë, Finiq dhe Konispol).

Janë vlerësuar me **2 pikë** ato bashki të cilat kanë një realizim në nivelet 70%-80% të buxhetit (fakt/kundrejt planit), ose me performancë mesatare buxhetore. Konkretisht rezultojnë **26 bashki** (Berat, Klos, Mat, Durrës,

Shijak, Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Përrenjas, Fier, Lushnje, Roskovec, Dropull, Libohovë, Devoll, Korçë, Maliq, Pogradec, Kurbin, Lezhë, Fushë-Arrëz, Malësi e Madhe, Kavajë, Sarandë dhe Selenicë).

Janë vlerësuar me **3 pikë** ato bashki të cilat kanë një realizim në nivelet nën 70 % të buxhetit (fakt/kundrejt planit), ose me performancë të dobët buxhetore. Konkretisht rezultojnë **15 bashki** (Krujë, Divjakë, Mallakastër, Patos, Gjirokastër, Përmet, Pustec, Shkodër, Vau i Dejës, Kamëz, Rrogozhinë, Tiranë, Vorë, Himarë dhe Vlorë).






12. Përdorimi i raporteve të monitorimit nga qytetarët

Publikimi në internet i raportit vjetor të monitorimit mundëson transparencë ndaj komunitetit por njëkohësisht i mundëson atij të njihet me zbatimin e buxhetit në mënyrë të hollësishme dhe t'i mbështetë kërkesat e veta në fakte të prodhuara dhe të miratuara nga bashkia.

Sikurse duket nga harta më poshtë vetëm 48 bashki nga 61 e kanë publikuar raportin në internet, kurse pjesa tjetër e bashkive nuk e kanë publikuar RZMB-në në faqen e internetit të bashkisë. Për më shumë hollësi i referohemi hartës x dhe grafikut y dhe z.

Harta 11: Vendorsja e RMZB-së 2021 në web




Gjithsesi kriteri ka ardhur me përmirësim nga viti i kaluar ku numri i bashkive më transparente në këtë aspekt është rritur me 13 bashki.

Referuar grafikut më poshtë, për trendin 4-vjeçar të treguesit nëse raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit është publikuar në internetit duke i krijuar qasje qytetarëve dhe aktorëve të tjerë për përdorim rezultojn se:

Për vitin 2019, nga 61 bashki 25 e kanë publikuar raportin, për vitin 2020 krahasuar me 2019 treguesi është me përmirësim duke e çuar numrin në 35 bashki që publikojnë raportin, gjithashtu edhe për vitin 2021 treguesi paraqitet me trend rritës pra me përmirësim duke e çuar numrin e bashkive që kanë publikuar raportin në 48, pra rreth 13 bashki më shumë.

RAPORTI NE WEB 2019-2021



Shënim: Për këtë treguesi viti i parë i parë i përfshirjes në këtë raport është viti 2019

13. Përdorimi i raportit të monitorimit nga Këshilli bashkiak




Referuar hartës së mëposhtme, konstatohet se 47 bashki e kanë diskutuar raportin në këshill, pjesa tjetër e bashkive (14) nuk e kanë diskutuar.

Referuar grafikut të mëposhtëm ku marrim në krahasim vitin 2021 me 2020, na rezultojn se 4 bashki paraqiten me përmirësim si Durrës, Mallakastër, Mirditë dhe Vau i Dejës. Më regres paraqiten 3 bashki, me status të njëjtë pozitiv 44 bashki, ndërsa me status të njëjtë negativ janë 10 bashki.

Referuar grafikut më poshtë, për trendin 4-vjeçar të treguesit nëse raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit është përdorur nga këshilli bashkiak rezultojn se:


Për vitin 2019, nga 61 bashki në 36 bashki raporti është përdorur nga këshillat bashkiake, për vitin 2020 krahasuar me 2019 treguesi është me përmirësim duke e çuar numrin në

Harta 12: Përdorimi i raportit në Këshillat Bashkiake 2021



47 bashki raporti i të cilave është përdorur nga KB-ja, gjithashtu edhe për vitin 2021 trendi i treguesit paraqitet në të njëjtat nivele me ato të vitit 2020, pra 47 bashki raporti i monitorimit i të cilave është përdorur nga këshillat bashkiake.

RAPORTI I DISKUTUAR- TRENDI 2019-2021



Shënim: Për këtë tregues viti i parë i parë i përfshirjes në këtë raport është viti 2019




14. Nota e Përputhshmërisë

Pikët e secilës bashki, derivuar nga plotësimi, mosplotësimi apo plotësimi i pjesëshëm i kriterëve janë mbledhur duke rezultuar në një "total pikësh" për çdo bashki, ku maksimumi i mundshëm është 13 pikë (13 kriterë) dhe minimumi 0 pikë. Harta e mëposhtme tregon 4 kategori: Bashkitë e ngjyrosura me jeshile të errët kanë përputhshmëri të lartë me 10,4 deri 13 pikë. Bashkitë e ngjyrosura me jeshile kanë përputhshmëri mbi mesatare duke marrë 7,8-10,4 nga 13 të mundshme, bashkitë me ngjyrë gri kanë përputhshmëri mesatare të cilat kanë marrë 5,2-7,7 pikë, bashkitë e ngjyrosura me të kuqe nuk i kanë plotësuar kërkesat në lidhje me raportimin.

Nga 61 bashki, 41 prej tyre (11 më shumë se vitin e kaluar) kanë raportuar duke plotësuar shumicën e kriterëve, pra kanë përputhshmëri të lartë, 9 bashki (12 më pak se vitin e kaluar) kanë përputhshmëri mbi mesataren, 5 bashki kanë përputhshmëri mesatare dhe 6 bashki nuk i kanë plotësuar kriteret.

Në krahasim me vitin e kaluar renditja vazhdon të ketë përmirësim ku nga 30 bashki me përputhshmëri të lartë në vitin 2020, në vitin 2021 rezultojnë 41, nga 20 bashki me notë mbi mesatare në 2020 kemi 9 në vitin 2021, nga 2 bashki me notë mesatare në vitin 2020 kemi 5 bashki në 2021 dhe nga 8 bashki që nuk kanë pasur fare përputhshmëri, për vitin 2021 janë vetëm 6. Nota mesatare është rritur përsëri nga 9,2 në vitin 2020 në 9,76 në vitin 2021

Harta 13: Renditja e përputhshmërisë së RMZB-së në vitin 2021 me kuadrin ligjor




Në mënyrë të përmbledhur, përmirësim kanë shënuar 25 bashki, 13 bashki kanë shënuar luhatje negative në notë, ndërsa 17 kanë qëndruar në të njëjtin nivel të mirë, dhe 6 nuk e kanë prodhuar raportin.

Sikurse duket nga ecuria e notës së përputhshmërisë, raportimi i buxhetit dhe zbatimi i sistemit të performancës buxhetore ka ardhur duke u përmirësuar. Vihet re një ngadalësim i përmirësimit në vitin 2021. Kjo sinjalizon që bashkitë që nuk kanë arritur

akoma përputhshmërinë mund të kenë nevojë për stimuj apo aftësim të dedikuar për të arritur përputhshmërinë ligjore në lidhje me raportimin e buxhetit me bazë performance.

Analiza e ecurisë së kriterëve për periudhën 2018-2021, tregon se kriteret janë përmbushur nga një numër më i madh bashkish nga viti në vit përveç raportimit të treguesve financiarë, detyrimeve të prapambetura dhe zbatimit të buxhetit.



Criteria	Trend 2018-2021	Municipalities missing benchmark
Monitoring Report Produced	↑	6
Financial Ratios Reporting	→	19
Expenditure by Program Reporting	↑	6
Revenue by Source Reporting	↑	14
Revenue Plan vs. Fact Reporting	↑	13
Economic Classification Reporting	↑	8
Performance Information Reporting	↑	14
Investment Projects Reporting	↑	10
Arrears*	→	18
Budget Execution**	→	20
Report uploaded on Website	↑	14
Report discussed in Council	↑	13

4. Rekomandime

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka punuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore përgjatë vitit 2021, në funksion të përmirësimit të raporteve të monitorimit.

Për shumë nga treguesit e marrë në analizë në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit 2021, krahasuar me atë në një vit më parë ka përmirësim të ndjeshëm në shumicën e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Pavarësisht rekomandimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në raportin e përputhshmërisë së vitit të kaluar, procesi i monitorimit vazhdon të ketë problematika në drejtim të standardizimit të formatit dhe informacionit që duhet të përmbajë RMZB-ja, përmirësimit të informacionit financiar dhe cilësor, përmirësimit të analizës dhe argumenteve të paraqitura për realizimin e çdo programi buxhetor, plotësimit të të gjitha anekseve në përputhje me udhëzimin standard të monitorimit.

1. Informacioni i paraqitur në raportin e monitorimit për produktet sipas programeve, ka vështirësi për t'u kuptuar nga një njësi vendore në njësinë tjetër, është i shkruar jo saktë, pa argumente dhe ka mospërputhje midis informacionit të paraqitur në relacionin shoqërues me atë të paraqitur në anekset shoqëruese të monitorimit.

- *Rekomandim:* Të harmonizohet dhe saktësohet informacioni i paraqitur në dokumentin e raportit të monitorimit dhe informacioni i paraqitur në tabelat dhe anekset shoqëruese lidhur me statusin e realizimit të produkteve buxhetore duke dhënë argumente.

2. Përdoren programe buxhetore të cilat nuk janë pjesë e udhëzimit standard të miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

- *Rekomandim:* Të hartohet dhe të zbatohet buxheti bazuar në listën e programeve të miratuar në shtojcën 1, të udhëzimit nr. 7 datë 25.02.2022, "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore".

3. Detyrimet e Prapambetura. Në raportet e monitorimit bashkitë nuk paraqesin informacion për monitorimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Gjithashtu, konstatohet se disa prej njësive vendore nuk e respektojnë planin e shlyerjes së detyrimeve dhe marrin angazhime buxhetore pa analizuar kapacitetin për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

- *Rekomandim:* Evidentimi i vlerës së detyrimeve të prapambetura si dhe i planit të hartuar për likuidimin e tyre. Parandalimi i krijimit të detyrimeve të prapambetura duke u fokusuar dhe analizuar të gjithë ciklin buxhetor (hartimi i PBA-së deri në miratimin e ligjit vjetor të buxhetit). Planifikimi i shpenzimeve duke mbajtur parasysh angazhimet buxhetore për periudhën afatmesme.

4. Në raportin e monitorimit nuk paraqitet informacion për përcaktimin e treguesve të performancës, kostove për njësi sipas programeve buxhetore.

- *Rekomandim:* Përcaktimi i sasive për çdo tregues performance, shpenzimeve për çdo tregues si dhe kostove për njësi apo konstatimi i luhatjeve të kostove për njësi sipas periudhave (faktit viti paraardhës, plani viti korrent, plani i rishikuar viti korrent, fakti viti korrent).

5. Në raportin e monitorimit mungon një informacion dhe analizë e hollësishme mbi projektet e investimeve.

- Rekomandim: Në raportin e monitorimit është e rëndësishme të paraqiten edhe shkaqet e mungesës së projekteve të reja të investimeve për vitin korrent. Gjithashtu, të paraqiten argumentet lidhur me shkaqet të cilat kanë ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve kapitale për projekte të caktuara. Totali i shpenzimeve për investime të paraqitura në relacionin shoqërues duhet të jetë në përputhje me totalin e plan-fakt për projektet e investimeve me financim të brendshëm/huaj sipas aneksit 5.

6. Planifikim i buxhetit dhe zbatimi i tij.

Në disa bashki është konstatuar se ka mospërputhje midis buxhetit të planifikuar dhe atij faktik, duke vështirësuar situatën financiare dhe si rrjedhojë krijimin e problematikave me ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

- Rekomandim: Bashkitë duhet të hartojnë dhe planifikojnë buxhetin duke mbajtur parasysh: Nivelin e dëshiruar të shërbimeve që i ofrohet qytetarëve, sasinë dhe cilësinë e produkteve të synuara, aftësinë paguese të NJVV-së, kërkesat buxhetore për çdo program (paga, sigurime, shpenzime operative, investime), tavanet buxhetore, prioritetet e reja të NJVV-së, projektet me ndikim në objektivin e programit dhe objektivin strategjik, kapacitetet financiare për investime kapitale të NJVV-së. Bashkitë duhet të përdorin të njëjtët tregues performance të planifikuar në PBA në RMZB duke komentuar realizimin ose mosrealizimin e tyre.

7. Në disa bashki mungon informacioni për treguesit kryesorë financiarë.

- Rekomandim: Paraqitja e informacionit mbi treguesit financiarë, i cili është i rëndësishëm për të bërë të mundur vlerësimin e qëndrueshmërisë financiare të njësisë vendore, sipas përcaktimeve të Udhëzimit Standard

nr. 22 datë 30.07.2018 "Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore".

8. Mungesa e analizës së treguesve ekonomikë dhe financiarë në përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe buxhetit vjetor.

- Rekomandim: Të merret parasysh pasqyrimi i parashikimeve të treguesve ekonomikë dhe financiarë të buxhetit, duke u bazuar në prioritetet e NJVV-ve dhe në planin strategjik të zhvillimit në këto vite.

9. Parashikimi jo i saktë i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore ndikon negativisht në përmbushjen e objektivave për programet buxhetore sipas funksioneve që ushtrojnë bashkitë.

- Rekomandim: Parashikimi i taksave dhe tarifave vendore nuk duhet të jetë i njëjtë për të tri vitet e programit buxhetor afatmesëm, duke mos marrë parasysh pasqyrimin e parashikimeve të treguesve ekonomikë dhe financiarë të buxhetit, si dhe nevojat e domosdoshme të përmirësimit të shërbimeve që do të kryhen në sektorë të ndryshëm, duke u bazuar në prioritetet e NJVV-ve dhe në planin strategjik të zhvillimit në këto vite.

10. Relacioni shpjegues në disa prej njësive të vetëqeverisjes vendore nuk përmban një informacion të hollësishëm për të gjithë procesin e monitorimit, duke pasqyruar probleme në cilësinë e të dhënave që paraqiten dhe analizohen.

- Rekomandim: Relacioni duhet të përmbajë një analizë shumë të hollësishme të realizimit të shpenzimeve sipas programeve, si dhe realizimin e të ardhurave sipas burimeve të financimit. Analiza duhet të jetë e saktë në formë përshkruese, tabelore dhe grafike. Në raportin e monitorimit duhet të paraqitet një informacion i hollësishëm mbi procesin e monitorimit, ecurinë e realizimit të qëllimit dhe objektivave për çdo program.

11. Në raportin e monitorimit nuk paraqitet raporti i objektivave të synuar dhe treguesit e performancës për çdo program, si një pjesë shumë e rëndësishme për të evidentuar produktet dhe më pas të vijohet drejt objektivit kryesor për kostimin e tyre.

- Rekomandim: Në raportin e monitorimit është e rëndësishme të paraqitet raporti i objektivave të synuara dhe treguesit e performancës për çdo program. Kjo për të evidentuar produktet dhe më pas të shkojmë drejt objektivit kryesor kostimin e tyre. Për të gjitha programet duhet të plotësohen të dhënat mbi realizimin e treguesve të performancës/produkteve, të paraqitura sipas aneksit nr. 4 "Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit", të përcaktuar në udhëzimin standard të monitorimit, si dhe është e rëndësishme plotësimi i komenteve për secilin tregues për të evidentuar arritjet si edhe problematikat. Bashkia duhet t'i përdorë këta tregues për të përcaktuar fushat prioritare për ofrimin e shërbimeve për vitet në vazhdim.

12. Konstatohet se nga disa bashki raporti i monitorimit paraqitet pa bërë një analizë të faktorëve të cilët kanë ndikuar negativisht në realizimin e shpenzimeve të planifikuara sipas programeve. Kjo analizë është e rëndësishme duke përmirësuar edhe procesin e planifikimit në vitin e ardhshëm buxhetor.

- Rekomandim: Të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të paraqesin raportin e monitorimit të plotë duke përfshirë edhe një analizë të hollësishme të shkaqeve që kanë sjellë mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara sipas programeve. Monitorimi duhet të përmbajë edhe argumentet përkatëse të bashkisë lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar në nivel programi dhe zëri.

13. Publikimi dhe diskutimi i raportit të monitorimit

- Rekomandim: Në kuadër të transparencës raporti i monitorimit i buxhetit vjetor duhet të diskutohet në këshill dhe të publikohet në faqen zyrtare të internetit të bashkive me qëllim që të jetë i aksesueshëm nga të gjitha grupet e interesit.

14. Pamvarësishte përmiresimeve nga vit në vit të bashkive sipas kriterëve të përputhshmërisë, përsëri mbetet ende shumë punë për tu bërë.

- Rekomandim: Rishikimi i kriterëve të përputhshmërisë, përmirësimi i tyre në aspektin cilësor dhe kombinimi me kriterë të tjerë duke i mbështetur me incentiva financiare (grande performance) me qëllim ndihmën e një sistemi vlerësimi funksional të performances në NJVQV-të

